



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KRYETARI

Nr. 2017 / Prot.

Pogradec, më 20.06. 2024

Lënda : Dërgohet material për shqyrtim e miratim.

ZNJ.MANJOLA KAMOLLI
KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

E nderuar Znj. Kryetare ,

Bashkëngjitur po ju dërgojmë projekt-vendimin dhe relacionin shoqërues :

**“PËR MIRATIM TË IMPLEMENTIMIT NË RAST APROVIMI TË PROJEKTIT ME
TITULL ‘HARMONIA E TRASHËGIMISË KULTURORE:LIDHJA KULTURORE QË
BASHKON OHRIN DHE POGRADECIN- H2COPE ‘**

**NË KUADËR TË PROGRAMIT NDËRKUFITAR MAQEDONI E VERIUT-
REPUBLIKA E SHQIPËRISË NËN INSTRUMENTIN E ASISTENCËS SË
PARAANTARËSIMIT (IPA III) ALOKIMI PËR VITIN 2022”**

Me respekt,

KRYETAR

Ilir Xhakolli

Nr.i faqeve A4 të projekt-vendimit : 2

Nr.i faqeve A4 të relacionit shoqërues : 3





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. _____ Prot.

Pogradec, më _____.2024

PROJEKT – VENDIM

NR. _____, DATË _____.2024

**PËR MIRATIM TË IMPLEMENTIMIT NË RAST APROVIMI TË PROJEKTIT ME
TITULL “HARMONIA E TRASHËGIMISË KULTURORE : LIDHJA KULTURORE
QË BASHKON OHRIN DHE POGRADECIN-H2COPE”**

**Në kuadër të Programit Ndërkufitar Maqedoni e Veriut–Republika e Shqipërisë nën
Instrumentin e Asistencës së Paraantarësimit (IPA III) alokimi për vitin 2022.**

Në mbështetje të Ligjit nr.139 datë 17.12.2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, VKM nr.450 datë 26.07.2018 “Për bashkërendimin dhe koordinimin e procesit të integritit evropian, ndërmjet qeverisjes qendrore dhe njësive të vetëqeverisjes vendore” pika 1.2 Koordinimi i programeve të asistencës së Bashkimit Evropian në nivel vendor dhe projekteve ku përfiton Bashkia,

- Mbështetja dhe drejtimi i strukturave administrative të Bashkisë për përgatitjen e projekteve në kuadër të programeve të asistencës së Bashkimit Evropian si dhe informimi i qartë për Thirrjet për Aplikime të shpallura në kuadër të Programeve të Bashkëpunimit Ndërkufitar dhe Territorial të Bashkimit Evropian.
- Bashkërendimi dhe koordinimi me strukturat e Bashkisë dhe Këshillin Bashkiak për përfshirjen e të gjitha projekteve të financuara nga donator në buxhetin vjetor si dhe në Programin Buxhetor Afatmesëm si dhe parashikimin e detyrueshëm të kostos lokale, bashkëfinancimit, nëse ka dhe TVSH, me propozimin e Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak

VENDOSI :



1. Të miratojë implementimin në rast aprovimi të projektit me titull **“HARMONIA E TRASHËGIMISË KULTURORE : LIDHJA KULTURORE QË BASHKON OHRIN DHE POGRADECIN-H2COP”** në kuadër të Programit Ndërkufitar Maqedoni e Veriut –Republika e Shqipërisë nën Instrumentin e Asistencës së Paraantarësimit (IPA III) alokimi për vitin 2022.

2. Bashkia Pogradec si partner në këtë projekt bazuar në kushtet dhe kriteret e aplikimit në projektet IPA, në rastin e miratimit të këtij projektit nga vlerësuesit e Delegacionit Evropian, të marrë përsipër mbulimin e kostos së bashkëfinancimit të projektit dhe TVSH-në për projektin.


3. Të autorizohet administrata e Bashkisë Pogradec për zbatimin e vendimit si dhe të ndjek të gjitha hapat e duhura për ecurinë e projektit.

4. Për zbatim të këtij vendimi, ngarkohen Kryetari i Bashkisë.

Vendimi hyn në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.

KRYETARE E KËSHILLIT

Manjola Kamolli



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
NJËSIA E INTEGRIMIT EVROPIAN

RELACION

Të nderuar këshilltarë!

Në mbështetje të Ligjit nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", VKM nr.450 datë 26.07.2018 "Për bashkërendimin dhe koordinimin e procesit të integrimit evropian, ndërmjet qeverisjes qendrore dhe njërive të vetëqeverisjes vendore" pika 1.2 Koordinimi i programeve të asistencës së Bashkimit Evropian në nivel vendor dhe projekteve ku përfiton Bashkia,

- Mbështetja dhe drejtimi i strukturave administrative të Bashkisë për përgatitjen e projekteve në kuadër të programeve të asistencës së Bashkimit Evropian si dhe informimi i qartë për Thirrjet për Aplikime të shpallura në kuadër të Programeve të Bashkëpunimit Ndërkufitar dhe Territorial të Bashkimit Evropian.
- Bashkërendimi dhe koordinimi me strukturat e Bashkisë dhe Këshillin Bashkiak për përfshirjen e të gjitha projekteve të financuara nga donator në buxhetin vjetor si dhe në Programin Buxhetor Afatmesëm si dhe parashikimin e detyrueshëm të kostos lokale, bashkëfinancimit, nëse ka dhe TVSH,

Ju paraqesim për miratim paraprak në rast fitimi të projektit me titull "HARMONIA E TRASHËGIMISË KULTURORE: LIDHJA KULTURORE QË BASHKON OHRIN DHE POGRADECIN- H2COPE "

Ky projekt është në kuadër të granteve të thirrjes së parë për propozime të Programit të Bashkëpunimit Ndërkufitar 2021-2027 Maqedoni e Veriut-Republika e Shqipërisë,

Partner në këtë projekt janë:

1. Bashkia Ohër, lider projekti.
2. Bashkia Pogradec, partner.



3. "Institute for Sustainable Policies" (ISP) OJF për palën shqiptare ,partner.

4. "Preda Plus" OJF për palën maqedonse, partner

Vlera totale e projektit për të dyja palët shqiptare dhe maqedonse: 1,013,712.00 euro

Buxheti për Bashkinë Pogradec 331,404,40 euro.

Bazuar në buxhet, Bashkia Pogradec ka detyrimin e kostos së bashkëfinancimit në vlerën 15.000 euro dhe TVSH-së së projektit.

Qëllimi i projektit: Përmirësimi i infrastrukturës turistike dhe aksesit të vendeve turistike dhe kulturore nëpërmjet investimeve të dy qyteteve ndërkufitare, Pogradecit dhe Ohrit.

Projekti është në fushën e turizmit dhe trashëgimisë kulturore dhe ka në fokus për palën shqiptare realizimin e aktiviteteve që lidhen me rehabilitimin dhe rivitalizimin e rrugës që të çon në Kalanë e qytetit në një gjatësi prej 2.3 km. Ky projekt do jetë plotësues i projektit të parë që është financuar nga BE dhe që ka të bëjë me rivitalizimin e mureve të kalasë Pogradec. Në këtë mënyrë rivitalizojmë të gjithë këtë zonë duke e kthyer në një atraksion turistik me vlerë dhe rëndësi të veçantë për qytetin.

Përfitimet nga ky projekt nuk do të ishin vetëm për këtë pjesë të qytetit, por në terma afatgjatë i gjithë qyteti i Pogradecit do të kishte përfitime në aspektin turistik, ekonomik dhe kulturor.

Nëpërmjet rehabilitimit të rrugës, mundësi për të aksesuar Kalanë e qytetit, do mundësohet shtrirja e turizmit dhe në këtë zonë të Pogradecit e cila deri tani është vizituar pak ose aspak nga turistët shqiptarë dhe ata të huaj.

Nëpërmjet këtij projekti të përbashkët, autoritetet publike në këto dy bashki do të fitojnë një kuptim më të thellë të territoreve të përfshira, duke zhvilluar potencialin turistik dhe duke promovuar trashëgiminë dhe vlerat kulturore. Qëllimi është të stimulohet zhvillimi i balancuar, gjithëpërfshirës dhe i qëndrueshëm social-ekonomik në zonën ndërkufitare, zhvillimi i potencialit turistik duke promovuar trashëgiminë dhe vlerat kulturore si në Bashkinë e Ohrit ashtu edhe Bashkinë e Pogradecit.

Të gjitha aktivitetet që do realizohen në kuadër të projektit do jenë konform rregullave të miratuara nga institucionet përkatëse, të cilat do japin rekomandimet dhe lejet e nevojshme për ndërhyrje në këtë zonë, ku nuk do preken rekomandimet e UNESCO-s dhe nuk do kenë impakt në ndotjen e mjedisit, kushte paraprake këto për t'u mbajtur në konsideratë në projekt.

Njësia e Integritimit Evropian, me qëllim përmbushjen me sukses të objektivave të procesit të integritetit evropian, ku kusht është dhe zbatimi me rigorozitet i projekteve IPA Ndërkufitare duke kaluar të gjitha hallkat ligjore që nga miratimi në Këshillin Bashkiak deri tek kontrolli dhe çertifikimi i shpenzimeve, kërkon vlerësimin e impaktit të këtij projekti nga Këshilli Bashkiak, miratim të implementimit në rast aprovimi të projektit dhe mbështetjen për të çuar para këtë projekt.

Faleminderit!



Konceptoi: Irsa Kadilli
Specialiste Njësia e Integrimit

Pranoi: Blerta Çomo
Përgjegjëse e Njesisë së Integrimit Evropian

Miratoi: Paskalino Ziko
N/Kryetar

Konfirmoi: Ditan Babasuli
Sekretar i Përgjithshëm

KRYETAR

Ilir Xhakolli